

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË SHTETËRORE PËR PRODHIMIN DHE TREGTIMIN E ARMËVE, MUNICIONEVE, PAJISJEVE DHE TEKNOLOGJIVE USHTARAKE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj ka si qëllim krijimin e një shoqërie shtetërore për prodhimin, demilitarizimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake, si dhe përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së saj.

Gjithashtu, ky projektligj ka për qëllim të shërbejë si akt themelimi për shoqërinë KAYO sh.a.

Nëpërmjet kësaj nisme bëhet e mundur krijimi i një strukture të re në formën e një shoqërie tregtare më të gjitha kapacitetet e nevojshme për të ndërvepruar në tregun e sotshëm kombëtar dhe ndërkombëtar. Vetëm përmes një shoqërie të tillë mund të aktivizohen dhe funksionojnë mekanizmat e nevojshëm për rivitalizimin e kapaciteteve të trashëguara të industrisë ushtarake, - në kuadrin e dinamikave aktuale në ambientin ndërkombëtar strategjik të sigurisë, vendimet dhe standardet e NATO-s.

Gjithashtu ky proces ka për qëllim të nxisë inovacionin dhe zhvillimin teknologjik në fushën e industrisë së mbrojtjes, nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë me sektorin privat.

Me anë të kësaj nisme ndërmerret hapi i parë drejt rivitalizimit të industrisë ushtarake. Në këtë mënyrë, Shqipëria forcon pozicionin e saj strategjik në rajon, duke u bërë një aktor më i rëndësishëm në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, e përqasur me objektivat e Aleancës së Atlantikut të Veriut.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTAVE TË TJERA POLITIKE

Projektligji propozohet nga Ministria e Mbrojtjes dhe nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2024, për Ministrinë e Mbrojtjes.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Shqipëria ka trashëguar nga e kaluara një industri ushtarake e cila sot nuk ushtron veprimtarinë e saj dhe si rrjedhojë nuk mund t'i përgjigjet kërkesave të FARSH-it. Prej vitesh këto kërkesa dhe nevoja plotësohen në tregun ndërkombëtar.

Nga ana tjetër, dinamika gjeopolitike e dy viteve të fundit ka sfiduar bazën industriale globale të mbrojtjes, duke shkaktuar ndërprerje në zinxhirët e furnizimit, mungesë të fuqisë punëtore, shoqëruar kjo edhe me një kërkesë tepër të lartë globale për sisteme armatimesh dhe municionesh të kalibrave të ndryshëm. Shqipëria, ashtu edhe si të gjitha vendet e tjera aleate, ka si detyrim të rrisë kapacitetet operacionale dhe nivelin e rezervës në municione dhe armatime, për t'iu përgjigjur ndryshimit të vazhdueshëm të situatës së sigurisë dhe mbështetur ekzekutimin e “familjes së planeve” të shkurajimit dhe mbrojtjes në zonën euroatlantike. Përveç një detyrimi të tillë, për kushtet aktuale, angazhimi në fuqizimin e një industrie të tillë dhe aftësia për të qenë konkurrent në këtë treg, mund të konsiderohet edhe si një aktivitet fitimprurës për ekonominë e vendit.

Në këtë mënyrë, përmes krijimit të një shoqërie shtetërore synohet shfrytëzimi i kapaciteteve industriale të trashëguara, sikurse edhe integrimi në proceset e punës edhe i teknologjive të reja dhe inovacioneve. Shqipëria rrjedhimisht do të ndërtojë një efekt deterence, duke rritur pozicionimin strategjik në rajon. Paralelisht kjo do të kontribuojë në rritjen dhe zhvillimin ekonomik, duke e bërë industrinë e mbrojtjes një motor mbështetës për përparimin.

Shoqëria shtetërore që synohet të krijohet më këtë projektligj, do të ketë të gjitha kapacitetet e saj juridike dhe financiare për të funksionuar në përputhje me objektivat që i cakton ky projektligj për zhvillimin e industrisë ushtarake në vend.

Si përfundim, synimi strategjik për modernizimin e industrisë së mbrojtjes në përputhshmëri me standardet e NATO-s është jo vetëm i nevojshëm për të rritur kapacitetet mbrojtëse të Shqipërisë, por edhe për të forcuar pozicionin strategjik të vendit në rajon dhe në skenën ndërkombëtare të sigurisë, si dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik. Ringritja e industrisë ushtarake në vend do të kërkojë një qasje të integruar dhe të koordinuar që adreson jo vetëm aspektet teknologjike dhe operative, por edhe ato ligjore, financiare, ekonomike, sociale dhe ambientale. Për këtë arsye krijimi i një shoqërie shtetërore që do të funksionojë sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare, sikurse dhe dispozitave të këtij ligji, është hapi i parë i nevojshëm për përmbushjen e një synimi strategjik të tillë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR:

Projektligji “Për krijimin e Shoqërisë Shtetërore për prodhimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”, është në përputhje me Kushtetutën dhe rendin e brendshëm juridik.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNITAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE):

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet në tërësi nga **26** nene, më konkretisht:

Në nenin 1 të projektligjit përcaktohet qëllimi i këtij ligji.

Nëpërmjet këtij neni bëhet përcaktimi i emrit të Shoqërisë, si dhe krijimi i saj si shoqëri shtetërore për prodhimin demilitarizimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake.

Kjo shoqëri krijohet nisur nga situata globale e sigurisë dhe për zhvillimin e kapaciteteve kombëtare në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes së vendit.

Ky ligj shërben si akt themeltar për Shoqërinë Shtetërore KAYO sh.a.

Neni 2 i projektligjit parashikon objektin e veprimtarisë së Shoqërisë.

Objekti i saj i veprimtarisë lidhet me projektimin, prodhimin, riparimin, demilitarizimin dhe tregtimin e ligjshëm, brenda dhe jashtë vendit, të të gjitha llojeve të armëve ose pjesëve të armëve, përfshirë edhe armët ushtarake, municioneve, teknologjitë dhe pajisjeve ushtarake, si dhe çdo aktivitet të lidhur me këtë veprimtari, në funksion të politikave kombëtare të sigurisë dhe mbrojtjes dhe rritjes së kapaciteteve ushtarake. Sidoqoftë në çdo rast, si një shoqëri tregtare, veprimtaria e Shoqërisë lidhet me gjenerimin e të ardhurave dhe ndjekjen e interesave ekonomikë dhe tregtarë.

Neni 3 i projektligjit parashikon statusin juridik të Shoqërisë.

Shoqëria ngrihet si një person juridik e organizuar në formën e shoqërisë aksionare.

Aksionari i vetëm është shteti dhe autoriteti publik që përfaqëson shtetin është ministria përgjegjëse për mbrojtjen.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi për shoqëritë tregtare, Shoqëria ka stemën, logon dhe vulën e saj, të cilat miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Kapitali fillestar përcaktohet në statut.

Financimi i Shoqërisë në para ose në natyrë nëpërmjet pasurisë shtetërore bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në nenin 4 të projektligjit parashikohen objektivat e Shoqërisë.

Objektivat reflektojnë vizionin mbi industrinë ushtarake që synohet të ndërtohet dhe aktivitetin e plotë dhe gjithëpërfshirës, për sa lidhet me të gjitha fazat dhe ciklet e prodhimit, sikurse edhe me tregtimin.

Është përcaktuar si një ndër objektivat kryesorë të Shoqërisë zhvillimi më eficientë i veprimtarisë së saj në funksion të ngritjes, zhvillimit dhe fuqizimit të industrisë ushtarake në vend.

Në objektiva, si një prej elementeve më të rëndësishme është prodhimi dhe furnizimi me pajisje të nevojshme për Forcave të Armatosura dhe strukturat e tjera përgjegjëse të sigurisë në funksion të përmbushjes së misionit të tyre.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i objektivave lidhet me nxitjen e investimeve në teknologji dhe inovacion në kuadër të prodhimit, përdorimit dhe tregtimit të armëve brenda dhe jashtë vendit.

Paralelisht, përcaktohet edhe bashkëpunimi me subjekte të ndryshme shtetërore dhe private, kombëtare dhe ndërkombëtare në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së Shoqërisë.

Financimi ose bashkëfinancimi i projekteve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare ose subjekteve për qëllime të veçanta të ngritura për të realizuar këto projekte, është një tjetër objektivi i Shoqërisë i përcaktuar në kontekstin e udhëheqjes së veprimtarisë drejt fuqizimit të industrisë ushtarake.

Në nenin 5 parashikohen funksionet e Shoqërisë.

Funksionet e Shoqërisë lidhen me mënyrë të drejtpërdrejtë me qëllimin për të cilin Shoqëria po krijohet dhe në përputhje me objektivat kryesore.

Për këtë arsye, funksionet përqendrohen në disa aspekte:

- prodhim, riparim, demilitarizim dhe tregtim i armëve dhe pjesëve të armëve, përfshirë armët ushtarake, municionet, teknologjitë dhe pajisjet ushtarake dhe çdo aktivitet i lidhur me këtë veprimtari (në çdo rast, ky funksion ushtrohet në përputhje me politikat kombëtare të sigurisë dhe mbrojtjes, të politikave shtetërore të rritjes së kapaciteteve ushtarake, si dhe zhvillimit të industrisë ushtarake);

- bashkëpunim me FARSH për fuqizimin dhe rritjen e kapaciteteve të tyre ushtarake, nëpërmjet sigurimit të armëve, teknologjive dhe pajisjeve ushtarake në cilësinë Shoqërisë si furnizues, agjenti ose të autoritetit kontraktor;

- tregtimi, nga vetë Shoqëria (apo nga subjekte të tjera të themeluara prej saj ose në bashkëpunim me subjekte private) i armëve ushtarake ose pjesëve të tyre, municioneve, teknologjive dhe pajisjeve ushtarake, të prodhuara në territorin e Republikës së Shqipërisë;

- financimi ose bashkëfinancimi i projekteve ose subjekteve për qëllime të veçanta (SPV) të ngritura për realizimin e objektit të veprimtarisë së saj;

Përveç sa më sipër, Këshilli i Ministrave mund të autorizojë Shoqërinë të kryejë funksione të tjera sipas legjislacionit në fuqi.

Në nenin 6 parashikohen burimet financiare me të cilat kjo shoqëri do të financohet.

Burimet financiare për funksionimin e kësaj Shoqërie, parashikohen të jenë si fillim buxheti i shtetit për kapitalizmin dhe në vijim si mbështetje operationale për Shoqërinë derisa të jetë në gjendje të shpërndajë dividend

Pas momentit të parë të themelimit dhe ngritjes së kapaciteteve të saj, të ardhurat e siguruar nga aktiviteti dhe shërbimet e ofruara do të përbëjnë burimin të rëndësishëm të financimit.

Gjithashtu, mund të shërbejnë si burim financimi edhe donacionet apo burime të tjera të lejuara dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Si burim financimi mund të shërbejë edhe financimi nga institucione financiare, duke e kushtëzuar këtë me miratimin paraprak të Këshillit të Ministrave.

Nga ana tjetër, parashikohet krijimi i një fondi *ad hoc* nga Këshilli i Ministrave, me qëllim mbështetjen e operacioneve të veçanta të Shoqërisë. Operacionet specifike që do të mbështetet nëpërmjet këtij fondi do të miratohen rast pas rasti nga Këshilli i Ministrave, bazuar në vendimin e Komitetit Ndërmintor të Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Në tërësi, parashikimet e kësaj dispozite synojnë krijimin e të gjitha kushteve financiare që Shoqëria të mund të jetë e gatshme të ngrihet, forcohet dhe të jetë në gjendje që, nëpërmjet veprimtarisë së saj, të konkurrojë në treg.

Nga ana tjetër, parashikohet ndalimi i transferimit të detyrimeve financiare të Shoqërisë te buxheti i shtetit. Përgjegjësia për shlyerjen e detyrimeve financiare është detyrim i Shoqërisë.

Në nenin 7 parashikohet kryerja e studimeve dhe analizave të objektit dhe përmasave të investimeve që Shoqëria ka për qëllim të realizojë, sikurse edhe të mundësive objektive për realizimin e tyre.

Një element i tillë është i domosdoshëm për zhvillimin me eficiencë të aktivitetit të saj, sikurse është përcaktuar në nenet më sipër.

Në funksion të kryerjes së studimeve dhe analizave të tilla, parashikohet mundësia e Shoqërisë për të marrë ndihmë, kontraktuar apo nënkontraktuar nëpërmjet bashkëpunimit me subjekte shtetërore dhe private, vendase apo të huaja.

Në nenin 8 parashikohen lehtësirat që mund t'i ofrohen Shoqërisë në disa sektorë, me qëllim përshpejtimin dhe vendosjen në funksion të saj.

Lehtësirat që mund t'i shërbejnë një shoqërie të tillë për të garantuar operacionalitetin janë disa. Është hartuar një listë jo shteruese e tipologjive kryesore të lehtësirave. Në konceptimin e llojeve të lehtësirave janë menduar të gjitha hapat në të cilat kalon aktiviteti i Shoqërisë, duke filluar nga detyrimi për pajisjen më licencë në procedurat doganore e tatimore e deri në sigurimin e infrastrukturës së nevojshme dhe shërbimeve utilitare.

Neni 9 parashikon mundësinë që Shoqërisë t'i transferohet, sipas rastit, e drejta e pronësisë, përdorimit apo çdo e drejtë tjetër reale mbi pronat e paluajtshme të pronarit shtet. Kjo mundësi lidhet më ato prona të paluajtshme që do të identifikohen se i shërbejnë aktivitetit të Shoqërisë dhe projekteve që ajo do të synojë të realizojë dhe një transferim i tillë kryhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Gjithashtu, për të garantuar miradministrimin e pronës së paluajtshme, do të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave procedura, kriteret dhe mënyra e përdorimit të pronës në rastet kur për efekt të zhvillimit të aktivitetit të saj, Shoqëria ushtron të drejtat e saj mbi pronën nëpërmjet dhënies së saj në sipërmarrje, dhënies më qira apo përdorim sipas formave të tjera të parashikuara nga Kodi Civil.

Gjithashtu është vlerësuar e nevojshme të krijohet edhe hapësira ligjore që Shoqëria të përdorë pronën e paluajtshme si garanci kolateral etj. Sigurisht që kjo nuk mund të jetë një e drejtë e

pakufizuar. Kjo kushtëzohet nga miratimi i Këshillit të Ministrave dhe vetëm në funksion të veprimeve financiare në shërbim të rritjes së kapitalit, aseteve apo likuiditeteve të nevojshme.

Neni 10 parashikon mundësinë e Shoqërisë për të ndërvepruar dhe për të hyrë në marrëdhënie me palë të treta sikurse edhe mënyrat, format dhe procedurat për t'u ndjekur për realizimin e bashkëpunimeve. Këto palë të treta mund të jenë subjekte shtetërore ose private, vendase apo të huaja. Ndërveprimi mund të lidhet me të gjitha fazat e zhvillimit të veprimtarisë së Shoqërisë.

Shoqërisë i njihet e drejta që vetë ose me kërkesë të palave të treta, të bashkëpunojë me subjekte private, nëpërmjet pjesëmarrjes në bashkim operatorësh ekonomikë ose në partneritet publik privat si dhe nëpërmjet marrëveshjeve të ndryshme kontraktore, sipas përcaktimeve të legjislacionit civil dhe tregtar.

Përcaktohen aspektet kryesore procedurale për rastet e krijimit të bashkëpunimit kur Shoqëria kërkon partneritet, kur i paraqitet kërkesa për bashkëpunim sikurse edhe në rastet e lidhura ngushtësisht me interesin dhe politikat kombëtare në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, në të cilat Shoqëria mund të përzgjedhë drejtpërdrejt subjektin privat.

Parashikohet gjithashtu, si një element i rëndësishëm në kontekstin e natyrës së veprimtarisë, sigurimi i ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit të administruar nga Shoqëria, sipas rastit, në përputhje me kërkesat dhe kushtet e veçanta për mënyrën e administrimit të një sekreti shtetëror, tregtar, industrial etj.

Nga ana tjetër, nëpërmjet këtij neni Shoqëria ngarkohet edhe me përgjegjësinë për të kryer verifikime dhe mbikëqyrjen e domosdoshme në rastet e partneritetit me subjekte private për prodhimin e armëve dhe municioneve. Kjo kryhet në funksion të garantimit që subjekti përmbush detyrimet e nevojshme mbi licencimin, standardin e procesit të prodhimit etj.

Sipas këtij neni parashikohet edhe ushtrimi i së drejtës së vetos, në rastet e partneriteteve të krijuara për disa aspekte që lidhen me ndryshimin e statutit, zmadhimin/zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimit, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë dhe përfshirjen e aksionarëve të tjerë. E drejta e vetos parashikohet në funksion të garantimit të interesave të Shoqërisë.

Nga ana tjetër, e drejta e vetos në vendimmarrje parashikohet dhe përcaktohet edhe në funksion të detyrimit të Shoqërisë për të garantuar përmbushjen e kërkesave ligjore, parandalimin e keqpërdorimeve të mundshme të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake, si dhe ndalimin e konkurrencës së paligjshme brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 11 parashikon detyrimin e Shoqërisë për të zhvilluar aktivitetin e saj në bazë të licencave dhe lejeve të lëshuara nga autoritetet kompetente sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 12 parashikon detyrimet që do të ketë Shoqëria në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Pasqyrat financiare që gjenerohen nga veprimtaria e kësaj Shoqërie do të auditohen sipas legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor organizimin e profesionit të ekspertit kontabël.

Neni 13 parashikon detyrimet e Shoqërisë për të garantuar normat e sigurisë në disa aspekte.

Operacionet e Shoqërisë që lidhen me prodhimin riparimin dhe demilitarizimin e armëve, duhet të sigurohen nëpërmjet policave të sigurimit, në përputhje me procedurat e përcaktuara në aktet e brendshme rregullatore të Shoqërisë

Shoqëria ka detyrimin të sigurojë një strukturë operative për zbatimin dhe mbikëqyrjen e rregullave kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë së aplikueshme për prodhimin, riparimin dhe demilitarizimin e armëve.

Paralelisht, Shoqëria nge dhe operon infrastrukturë digjitale dhe kibernetike, personeli i të cilave pajiset me certifikatën përkatëse të sigurisë. Gjithashtu, informacioni i përpunuar është i mbrojtur sipas rregullave të mbrojtjes së sekretit shtetëror, tregtar apo industrial ushtarak.

Neni 14 parashikohen rrëgjimin e zbatueshëm të prokurimit.

Për kontratat në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, në kuadër të bashkëpunimit me strukturat përgjegjëse në këto fusha, zbatohet legjislacioni në fuqi për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë,

Për kontratat që nuk zbatohet legjislacioni si më sipër, Shoqëria vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi për shoqëritë tregtare.

Neni 15 parashikon rastet e veçanta kur kjo shoqëri duhet të garantojë dhe të sigurojë rezervë armatimesh municionesh dhe pajisjesh teknologjike për Forcat e Armatosura. Ky detyrim do të ekzistojë në rastin e gjendjes së luftës ose në kushtet e një rreziku të afërt dhe konkret të një agresioni ushtarak ndaj Republikës së Shqipërisë ose aleatëve të saj strategjikë.

Edhe pse Shoqëria operon në kushtet e tregut, prioritet në raste të tilla do të ketë plotësimi i kërkesave të FA-së. Kjo lidhet më interesin e përgjithshëm kombëtar.

Neni 16 përcakton organet drejtuese të kësaj Shoqërie, siç janë Asambleja e Përgjithshme, Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori Ekzekutiv. Ky organizim i organeve drejtuese është në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare.

Neni 17 parashikon kompetencat e njërës prej organeve drejtuese, siç është Asambleja e Përgjithshme, si dhe detyrat e saj.

Neni 18 parashikon përbërjen e anëtareve të njërës prej organeve drejtuese siç është Këshilli Mbikëqyrës. Ky këshill ka në përbërje përfaqësues nga Kryeministria, ministria përgjegjëse për mbrojtjen, ministria përgjegjëse për financat, si dhe përfaqësues nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të cilët emërohen dhe lirohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 19 parashikon disa nga kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës, si organ i kësaj Shoqërie, si dhe përmbushjen e disa prej detyrave, sipas parashikimeve të përcaktuara në legjislacionin e kësaj Shoqërie.

Neni 20 përcakton përfaqësuesin ligjor të kësaj Shoqërie, i cili do të jetë drejtori ekzekutiv. Si përfaqësues ligjor i kësaj Shoqërie, drejtori ekzekutiv përgjigjet përpara organeve të kësaj Shoqërie. Në këtë nen përcaktohet emërimi, lirimi nga detyra e tij në këtë funksion, si dhe çështje të tjera që lidhet me pagën.

Neni 21 përcakton kompetenca të drejtorit ekzekutiv të kësaj Shoqërie, nëpërmjet të cilave do të funksionojë kjo Shoqëri.

Krahas kompetencave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, drejtori ekzekutiv është përgjegjës edhe për ngritjen, ruajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës digjitale dhe atë kibernetike.

Neni 22 përcakton mënyrën e miratimit të strukturës dhe organikës të kësaj Shoqërie, si dhe marrëdhëniet e punës së personelit, të drejtat dhe disa detyrime shtesë në lidhje me standardet e sigurisë, për shkak të natyrës së veçantë që ka kjo Shoqëri.

Gjithashtu, në këtë nen parashikohen që, në mungesë të personelit me ekspertizë të thelluar, kjo Shoqëri gëzon të drejtën e kontraktimit të ekspertëve të jashtëm, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 23 parashikohen rastet e konflikteve të interesit për personelin që angazhohet si i punësuar në këtë Shoqëri, si dhe detyrimet që mbartin këta të punësuar në rastet e largimit nga puna.

Kjo më së shumti lidhet me natyrën delikate të proceseve të prodhimit në këto uzina, si dhe vlerën e njohurive të fituara në këto industri, duke mos i aplikuar në subjekte të tjera që mund të zhvillojnë konkurrencë.

Në nenin 24 parashikohen aktivitetet e Shoqërisë në funksion të realizimit të misionit të saj. Këto aktivitete do të ndahen në dy kategori:

Aktivitete të klasifikuara që përmbajnë dokumente apo procese sekrete për të cilat personeli i kësaj Shoqërie ka detyrimin të zbatojë rregullat sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar, sekretin tregtar, sekretin industrial etj.

Aktivitete të paklasifikuara për të cilat nuk zbatohet legjislacioni në fuqi për informacionin e klasifikuar.

Neni 25 parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore, si dhe dispozitat kalimtare.

Neni 26 parashikon hyrjen në fuqi të këtij ligji, në përputhje me nenin 84, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen: Këshilli i Ministrave, Kryeministria, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, si dhe Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIUBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosurave.

Projektligji do t'i dërgohet për mendim Kryeministrit, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Agjencisë së Prokurimit Publik dhe për dijeni Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMET BUXHETORE

Efektet fillestare të këtij projektligji në momentin e krijimit të kësaj Shoqërie janë në vlerën 300.000.000 (treqind milionë) lekë dhe do të përballohen nga fondi rezervë.

MINISTRI

Niko Peleshi